POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Protesta te kryeministria në ditën e 37-të, organizatorët thirrje SPAK: Hetoni librin 'Albanian Files'! Nis marshimi nëpër Tiranë

2 'U nis nga Rehova e Beratit dhe natën e kaloi në një repart në periferi të Vlorës', ana e panjohur e vizitës së Duçes në Shqipëri në '41-in

3 Sarandë/ Shkelën perimetrin e sigurisë dhe rrezikuan jetën e pushuesve, gjobiten me nga 500 mijë lekë të rinjtë! Bllokohen dhe 2 Jet Ski

4 Përplasjet për aeroportin e Vlorës, Pacolli: Hiqen kufizimet për VIA-n, asnjë vendim gjyqësor nuk pengon më përfundimin e punimeve

5 Dominojnë të rinjtë, qindra turistë nga Korfuzi në Sarandë: Deti i pastër dhe njerëz mikpritës! Rezervimet vijojnë dhe për gushtin

Kronikë

# Vrasja në Mirditë/ Autorët në ndjekje të 45-vjeçarit, kolegu i zbriti nga automjeti pak përpara se ta ekzekutonin me breshëri plumbash

*Një ditë pas vrasjes së 45-vjeçarit Valter Lleshi në zonën malore të Spaçit në Mirditë, policia ende nuk ka arritur të identifikojë autorët dhe as të sigurojë prova konkrete që mund të çojnë në zbardhjen e ngjarjes. Nga hetimet e deritanishme mësohet se viktima ishte nisur për në punë së bashku me një koleg, i cili është ndalur në një kafe pak minuta para atentatit, ndërsa Lleshi ka vijuar i vetëm rrugën.*

Vritet me breshëri plumbash në makinë 45-vjeçari, dyshohet si i përfshirë në vrasjen e Anton Kelit

Vrasja në Mirditë, kolegu i Valter Lleshit i shpëtoi plumbave! Ndaloi pë
Report TV

Watch on

Redaksia
16 Qershor, 09:20 | **Përditesimi: 16 Qershor, 18:41**

Share Post

Detaje të reja janë zbardhur ne lidhje me ngjarjen e ndodhur, mëngjesin e së hënës në zonën e Repsit, në Mirditë ku u ekzekutua me arme zjarri Valter Lleshi. Veprimet hetimore dhe dëshmitë e mbledhura deri më tani kanë ndihmuar në rindërtimin e lëvizjeve të viktimës para atentatit.

Sipas burimeve hetimore, 45-vjeçari kishte dalë nga banesa e tij në Rrëshen rreth orës 06:00 dhe së bashku me një koleg pune ishte nisur drejt kompanisë së bazaltit në Reps, ku punonte. Rreth dy kilometra para vendit ku ndodhi krimi, pasagjeri ka zbritur në një lokal, ndërsa 45-vjeçari ka vijuar rrugën i vetëm.Hetuesit dyshojnë se lëvizjet e viktimës jane ndjekur që nga momenti kur ai ka dale nga banesa dhe autoret janë sinjalizuar për itinerarin e tij dhe i kanë zënë pritë në një kthesë, rreth një kilometër pa mbërritur në vendin e punës.

45-vjeçari është qëlluar nga një distancë e afërt, duke marrë plagë të shumta në kokë dhe fytyrë. Mënyra e ekzekutimit, tregon vendosmërinë e autorëve për t'u siguruar që viktima të mos kishte asnjë mundësi shpëtimi. Gjatë 24 orëve të fundit, policia ka shoqëruar dhe marrë në pyetje disa persona që mund të kenë dijeni për ngjarjen, por deri tani dëshmitë e tyre nuk kanë ndihmuar në identifikimin e autorëve.



LEXO EDHE:
**Suedi/ Vritet me armë i riu nga Kosova, dyshohet viktimë e përplasjes së bandave kriminale**

Paralelisht, grupi hetimor po ushtron kontrolle në zonën ku ndodhi krimi në kërkim të gjurmëve të mundshme, ndërsa po analizohen edhe pamjet e kamerave të sigurisë në biznese në Rrëshen dhe përgjatë Rrugës së Kombit për të gjurmuar lëvizjet e autorëve para dhe pas atentatit.Valter Lleshi u gjet i vrarë rreth orës 07:10 të mëngjesit të së hënës në rrugën Reps–Spaç. Një nga pistat që po verifikohet lidhet edhe me dyshimet se ai mund të ketë pasur dijeni ose përfshirje në vrasjen e Anton Kelit, të ndodhur në vitin 2020 në Rrëshen. Për këtë çështje ai ishte marrë në pyetje në të kaluarën, por organet e drejtësisë nuk arritën të siguronin prova që ta implikonin në atë ngjarje.

K.B/E.H/Shqiptarja.com

TAG: mirdite valter lleshi vrasje Lezhe

Komento

## Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 3 Korrik, 10:41
**Sipas jush, protesta te Kuvendi a ka qenë e dhunshme nga ana e protestuesve?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera



Zjarr pranë plazhit të Tales në Lezhë! Punohet për shmangien e flakëve drejt banesave dhe bizneseve (VIDEO)
5 Korrik, 12:21



I dënuar për vrasje në Fier, arrestohet në Greqi shqiptari! Në kërkim prej tre dekadash!
5 Korrik, 11:50



Kurbin/ Shkrumbohen pesë mjete të tonazhit të rëndë në një gurore në Shpërdhet, zjarri dyshohet i qëllimshëm
5 Korrik, 11:24



Dogji mbeturinat pranë biznesit të tij dhe i vuri flakën malit të Shëngjinit, pranga 57-vjeçarit! Fshiu DVR-nën e kamerave të sigurisë për të fshehur provat (EMRI)
4 Korrik, 14:57



Lezhë/ Vihet nën kontroll zjarri në malin e Shëngjinit, digjen sipërfaqe të konsiderueshme! Arrestohet 57-vjeçari (EMRI + VIDEO)
4 Korrik, 07:26



Zjarr në malin e Shëngjinit, bimët e thata favorizojnë përhapjen e flakëve! Shpërthim brenda vatrës, lëndohet pasagjeri i një makine (VIDEO)
3 Korrik, 21:27



Shkarkime nga HEC-et, Miloti s'u shpëton përmbytjeve as në verë! Në Fier nis rehabilitimi i argjinaturës së lumit Vjosa
Elvis Hila
Marsela Topi
3 Korrik, 16:11



Masakra e Velipojës, arratiset Hasan Ferracaku, 'zhduket' nga banesa ku ruhej 24 orë nga policia! Arrestohen 4 efektivë
Ergys Kavaja
2 Korrik, 13:39



Pastrimi në Lezhë, debat për kamerat në Këshillin Bashkiak, PD: Cenojnë privatësinë! Ndreu: Janë vendosur për të parandaluar shkeljet
Elvis Hila
1 Korrik, 13:39



I akuzuar për vrasjen e policit Xhulio Prela në Lezhë në 2020, Apeli konfirmon pafajësinë për Redion Hysën! Arma e krimit u gjet në depozitën e ujit pranë banesës së tij
30 Qershor, 16:46



Aksion per hapësirat publike në Shëngjin, hiqen shezlonget e subjekteve private që kishin zaptuar plazhet
Elvis Hila
30 Qershor, 11:45



Shkoi të rregullonte dritat te shtëpia e vjehrrit, 45-vjeçarin e zë rryma elektrike dhe humb jetën
Elvis Hila
29 Qershor, 15:16







Lajmi i fundit



**Tepelena nga protesta: SPAK të veprojë mbi 'Albania Files', deputetët e PS të largohen nga Rama**
6 Korrik, 21:20



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

×
Lajmi i fundit



**Tepelena nga protesta: SPAK të veprojë mbi 'Albania Files', deputetët e PS të largohen nga Rama**

6 Korrik, 21:20

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton